

Gjuha e Thjeshtë

Mundësi punësimi për të gjithë

Udhëzime



Falënderojmë anëtarët e shoqatës
Klubi Dëshira

Grupi Kontrollues:

Lumnije Demolli

Driton Krasniqi

Hasan Krasniqi

Qëndrim Jashari



© European Easy-to-Read Logo: Inclusion Europe.

Më shumë informata në:

www.inclusion-europe.eu/easy-to-read

Gjuha e lehtë do të thotë që teksti është i kuptueshëm dhe i arrtishëm për të gjithë, pavarësisht nga aftësia intelektuale apo pengesa të tjera për të kuptuar.

Shënim: Përmbajta e kësaj broshure është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron detyrimisht pikëpamjet e Renovabis dhe Cartias Austria.

Hyrje

Kjo broshurë ju ndihmon si të punoni në një dyqan.

Të gjithë kanë të drejtë të punojnë!



Sipas Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, të gjithë kanë të drejtë të punojnë.



Në Kosovë çdo vend pune që ka më shumë se 50 punëtorë, duhet të punësojë 1 person me aftësi të kufizuara për çdo 50 punëtorë.

Pra, raporti i punësimit është 1 person me aftësi të kufizuara për çdo 50 punëtor.



Për çdo 50 punëtor - së paku 1 person me aftësi të kufizuara.

Për 100 punëtorë - së paku 2 persona me aftësi të kufizuara. E kështu me radhë.



Punëdhënësit duhet të sigurojnë kushte të barabarta për të gjithë.

Të gjithë punonjësit duhet të trajtohen me respekt dhe drejtësi.



Oferta e Punës

Nëse pranoresh në punë, do të marrësh një telefonat ose e-mail me një ofertë për një afat të caktuar.



Kjo do të thotë se punëdhënësi dëshiron të të japë punën, por do të dojë të të njohë pak më shumë fillimisht.

Çfarë pune mund të bëjmë në një dyqan?



Rregullimi i produkteve në raft.



Ndihma për klientët duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre.



Përdorimi i arkës dhe pranimi i pagesave (nëse është pjesë e punës tuaj).

Rregullat e punës në dyqan



Të punojmë sipas kërkesave të dhëna nga menaxheri.



Të jemi të përpiktë dhe të vijnë në kohë.



Të veshim uniformën ose rrobat e punës



Pastrimi dhe mbajtja e vendit të punës të pastër dhe të rregull.

Orari i punës dhe pushimet

Orari caktohet sipas marrëveshjes me punëdhënësin.




Pushimet janë e drejtë e të gjithëve dhe kur keni nevojë për pushim duhet ta kërkon.



Si të komunikojmë me klientët?

Të përshëndesim klientët me mirësjellje.



Të flasim qartë dhe me qetësi.

Nëse një klient ka nevojë për ndihmë, ta ndihmojmë ose ta drejtojmë te një koleg.

Mbështetja në punë



Nëse kemi pyetje apo shqetësime, mund të flasim me menaxherin ose kolegët.

Është e drejtë të kërkojmë mbështetje kur kemi nevojë.



Të gjithë duhet të ndihemi të sigurt dhe të respektuar në vendin e punës.



Dita e Parë në Punë

Të gjithë ndihen të frikësuar dhe të stresuar në ditën e parë të punës.



Përdorimi i qetësisë dhe kërkimi për ndihmë kur nuk je i sigurt për diçka mund të ndihmojë shumë.

Fillimi mund të jetë i vështirë por ti mund të marrësh mbështetje dhe ndihmë.



Të fillosh një punë të re mund të jetë gjithashtu edhe shumë e gëzueshme.

Ky udhëzues do të të ndihmojë të përgatitesh dhe të jesh gati për të nisur punën tënde të re.

Përgatitja për Ditën e Parë



Sigurohu që të merreni vesh se cilën ditë do të fillosh me punëdhënësin tënd.

Pyet nëse ka një kod veshjeje apo nëse duhet të veshësh një uniformë.



Planifiko mënyrën se si do të shkosh në punë para ditës së parë.

Sigurohu që e di kë mund ta kërkojsh kur mbërrin në ditën e parë.



Sigurohu që ke numrin e telefonit dhe adresën e punës.



Mos harro të flasësh me njerëz për mënyrën se si po e gjen punën tënde të re.

Kjo mund të jetë me familjen, miqtë, trajnerët e punës ose menaxherin e linjës në punë



Nëse ke nevojë për mbështetje ju lutem kontaktoni në Caritas Kosova apo në qendrën ku jeni të anëtarësuar.



Për të përmirësuar punën, ju lutemi vlerësoni tekstin.
Këtë mund ta bëni duke skanuar kodin QR ose
nëpërmjet lidhjes:

<https://forms.gle/qNbXxNhhXtiRCxh9>



**CARITAS
KOSOVA**

Përgatitur: Caritas Kosova www.caritaskosova.org /
383 (0) 290 328 110 info@caritaskosova.org
Adresa: Rr. Shën Nënë Tereza Nr. 3/Kisha Katolike
70000 Ferizaj, Kosovë